



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.19  
Prishtinë, më 15.5.2018, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku - Rexhepi, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovcu dhe Albulena Balaj - Halimaj.

**Munguan:** Arbërie Nagavci dhe Verica Çeraniq.

**Përfaqësues të tjerë:** Defrim Gashi-MASHT dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.5.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryesuesit të mbledhjes që pikat e rendit të ditës 2 dhe 4 të hiqen nga rendi i ditës.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës**

**Ismajl Kurteshi** tha se shqyrtimi i projektligjit për Inspektoratin e Arsimit është në fazën e fundit, por janë disa dilema sa i përket çështjes së Panelit të Artë, statusit të Inspektoratit, përcaktimit të sanksioneve, si dhe statusin e punëtorëve të inspektoratit të jenë shërbyes civil apo profesional. Gjithashtu tha se është e rëndësishme që komisioni të përcaktohet lidhur me pozitën e statusit ligjor të Inspektoratit, a duhet të mbetet brenda MASHT-it apo Agjencia e pavarur.

**Dëfrim Gashi** tha se qëndrimi i tij dhe ministrisë lidhur me statusin e inspektoratit është që inspektorati duhet të vazhdojë të funksionojë si organ i MASHT-it sepse përbën shtyllën kryesore të kësaj ministrie dhe përfaqëson të vetmin mekanizëm me anë të të cilit ministria zbrit ligjërisht deri në shkollë. Sa i përket nenit 21 që ka të bëjë me kundërvajtjet me gjobë, tha se kanë dhënë kontributin e tyre duke bërë ndryshimet që i kanë konsideruar si të nevojshme. Ndërsa lidhur me Panelin e Artë, tha që i njëjti parashihet të jetë një komision që do të merret me trajtimin e ankesave, kërkesave dhe trajtimin e planeve të ndryshme që lidhen me procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësit. Te dilema e statusit të punëtorëve të inspektoratit ai shprehu qëndrimin e tij duke thënë që inspektorët duhet të trajtohen si shërbyes civil.

**Nezir Çoçaj** tha që Paneli i Artë duhet të ekzistojë, ashtu siç është në projektligj, sepse është i nevojshëm për vlerësimin e mësimdhënësve dhe të performancës së tyre. Ndërsa sa i përket statusit të inspektoratit, ai mbështeti idenë që të funksionojë si Agjenci duke thënë që ky institucion nuk duhet të funksionojë nën ombrellën e MASHT-it. Ai tha që drejtori i Inspektoratit ka kontratë të përhershme dhe këtë nuk mund ta ndryshojë askush pa u ndryshuar ligji për shërbyesit civilë andaj mendoj që është mirë që ky udhëheqës të zgjidhet nga Qeveria, e jo nga një mekanizëm ku ndikimi politik është shumë i madh.

**Muferra Shinik** propozoi që te neni 3, nënparagrafi 1.14, i projektligjit për Inspektorat të Arsimit, tek inspektimi, mbikëqyrja dhe monitorimi në cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet, të shtohet edhe fjalia ”në gjuhët e të cilave zhvillohet arsimimi në Kosovë”, me arsyetimin që nëse inspektori nuk e njeh gjuhën e mësimdhënësve të komuniteteve atëherë ai nuk mund ta kuptojë mënyrën e funksionimit të arsimit.

**Teuta Haxhiu** tha që shqetësimin e ka te mungesa e inspektorëve lëndorë. Ndërsa sa i përket statusit të inspektoratit, ajo tha që ka ende dilema se a mund ta fuqizojnë inspektoratin nëse vepron si Agjenci në vete. Ajo tha gjithashtu që nëse bëhet Agjencia, a do të ketë bord dhe kush

do ta bëjë përzgjedhjen e këtij bordi. Në vazhdim tha se duhet të dyfishohet numri i inspektorëve që të rritet cilësia e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, si dhe të rregullohet çështja e inspektorëve lëndore.

**Fidan Rekaliu** tha që inspektorati duhet të funksionojë në kuadër të MASHT-it duke ditur obligimet dhe përgjegjësitë e Ministrisë për Arsimin në këtë vend.

**Albulena Balaj** tha që inspektorati duhet të vazhdojë të funksionojë në kuadër të MASHT-it sepse nëse bëhet Agjencia, një pjesë e përgjegjësisë i hiqet ministrisë. Ajo tha që ministria harton politika arsimore, por nuk mund të garantojë cilësi në arsim nëse nuk e ka inspektoratin si organ brenda vetes.

**Ismajl Kurteshi** shprehu dyshimet e tij lidhur me dy opsionet për funksionimin e inspektoratit. Ai tha që praktika e ka dëshmuar që Agjencia nuk i përmbushin detyrat dhe obligimet e tyre ashtu siç duhet, ndërsa si organ në kuadër të MASHT-it, cilësia e arsimit nuk po rritet. Ai tha se duhet të gjendet një model ku inspektorati nuk shkëputet nga MASHT-i por që i përgjigjet edhe një institucioni tjetër dhe të raportojë ose në Qeveri ose në Kuvend. Tha që nuk pajtohet me kontratat e përhershme të drejtorit të Inspektoratit dhe duhet të futet ndonjë amendament i përkohshëm për t'u testuar të gjithë njerëzit që janë në inspektorat, nga drejtori e tutje, që të shihet se a i plotësojnë kriteret e duhura. Për këtë mund të formohet ndonjë komision qoftë nga ministria, qoftë nga dikush tjetër.

**Dëfrim Gashi** tha që nëse Inspektorati i Arsimit vendoset të funksionojë si organ qendror, atëherë është më shumë se departament dhe më pak se agjenci duke i raportuar drejtpërdrejt ministrit, e jo sekretarit të Përgjithshëm. Edhe rregullorja që është në fuqi i jep të drejtë inspektoratit me qenë organ qendror. Sa i përket sqarimit që e kërkoi deputetja për gjuhët e komuniteteve përkatëse, ai tha që ne e kemi zbatuar këtë formulë, në Prizren janë inspektorët edhe për komunitetin turk edhe për komunitetin boshnjak.

**Muferra Sinik** tha se nuk po kërkon asgjë më shumë se sa që i takon me ligj dhe që pret përkrahjen e Komisionit për ta vendosur këtë amendament në ligj ose do të vazhdohet me gjykatë kushtetuese sepse nuk humb asgjë nëse shtohet veç një fjali.

Pas diskutimeve lidhur me statusin e Inspektoratit të Arsimit, kryesuesi e hodhi në votim propozimin që statusi i Inspektoratit të Arsimit të mbetet siç është në projektligj apo si Agjenci e pavarur.

Komisioni me 6 (gjashtë) vota për, 2 (dy) kundër, vendosi që Inspektorati i Arsimit të mbetet në varësi të MASHT-it, siç është përcaktuar në projektligj.

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin nen për nen në Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit. Pas shqyrtimit dhe amendamentimit anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës do të shqyrtohen edhe çështje e përcaktimit të gjobave dhe amendamentet do të procedohen në komisionet e përhershme.

### **3. Të ndryshme.**

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**